



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT**

Nr. 480 Prot.

Tiranë, më 18.07.2016

N J O F T I M

**MBI DEKORIMIN E SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT NGA
PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
SH. T. Z. BUJAR NISHANI, ME DEKORATËN E ARTË TË
SHQIPONJËS.**

Siç jeni në dijeni, të gjithë punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH), drejtues njësisish dhe inspektorë, kanë qënë dhe janë të angazhuar në zbatimin e prioriteteve të miratuara nga Qeveria shqiptare dhe përmbushjen me profesionalizëm të të gjitha detyrave të dala për këtë qëllim, sipas drejtimeve të ndryshme.

Vlerësohet se këto detyra janë kryer në mënyrë korrekte, duke parandaluar veprime dhe situata që mund të cënonin Sigurinë Kombëtare të vendit.

E kemi konstatuar dhe transmetuar edhe më parë se këto detyra janë kryer në bashkëpunim dhe koordinim me institucione të tjerë ligjzatues shqiptarë si dhe me shërbime të tjerë partnerë. E kemi theksuar vazhdimisht rëndësinë e këtij bashkëpunimi dhe koordinimi për avancimin sasior dhe cilësor të sukseseve për përmbushjen e misionit ligjor të SHISH.

Me krenarinë që buron nga angazhimi serioz i SHISH, jemi të gëzuar t'ju transmetojmë se një vlerësim i tillë, është konkretizuar me akordimin nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH. T. Z. Bujar Nishani, nëpërmjet Dekretit të Tij nr. 9668, datë 29.06.2016, të Dekorates së Artë të Shqiponjës për Shërbimin Informativ të Shtetit; dekoratë e cila i'u dorëzua Drejtorit të SHISH, z. Visho Ajazi Lika.

Dekorata është akorduar me këtë motivacion:

“Për punën, përpjekjet, sakrificat dhe arritjet e vazhdueshme 25 vjeçare të punonjësve të Shërbimit Informativ të Shtetit në realizimin me guxim, qëndrueshmëri, besnikëri, përkushtim e vetmohim të detyrave të tyre ligjore; për forcimin e sigurisë së shtetit e qytetarëve të tij, si dhe për garantimin e suksesit të zhvillimit ekonomik, shoqëror, liberal e demokratik të vendit”.

Me datën 4 korrik 2016, në orën 09⁰⁰, në selinë e Presidencës së Republikës së Shqipërisë, në një ceremoni jopublike, në prani të Presidentit dhe stafit të Tij; të diplomatëve dhe përfaqësuesve të disa shërbimeve të tjerë partnerë; në prani të Drejtorit të SHISH, z. Visho Ajazi Lika dhe të disa drejtuesve të njësive të Bazës dhe të Aparatit Qendror të SHISH; u zhvillua ceremonia e dorëzimit të kësaj Dekorate.

Në fjalimet e rastit; si nga Presidenti i Republikës ashtu edhe nga Drejtori i SHISH z. Visho Ajazi Lika, u vu theksi në përkushtimin dhe profesionalizmin e punonjësve të SHISH si dhe në detyrimin dhe dobishmërinë e forcimit të punës me instancat vendimmarrëse shqiptare si dhe të bashkëpunimit e koordinimit të partneritetit midis SHISH, institucioneve ligjzatues shqiptarë dhe shërbimeve partnere.

Mbështetur në sa sipër, dëshiroj të falenderoj të gjithë materializuesit e një dekorimi të tillë, dmth, të gjithë punonjësit e SHISH në Bazë dhe AQ, si dhe drejtuesit e tyre, pa angazhimin dhe përkushtimin e të cilëve, ndër vite, një Dekorim i tillë nuk do të kishte qënë i mundur.

Duke i'u bashkuar edhe një herë përgëzimit "*Për punën, përpjekjet, sakrificat dhe arritjet e vazhdueshme 25 vjeçare...*"; vlerësimit për "*... realizimin me guxim, qëndrueshmëri, besnikëri, përkushtim e vetmohim të detyrave tona ligjore...*"; falenderimit "*... për garantimin e suksesit të zhvillimit ekonomik, shoqëror, liberal e demokratik të vendit*"; duke bashkuar edhe përgëzimin tim për kontributin e të gjithë punonjësve të SHISH në forcimin e mëtejshëm të kohezionit ndër-institucional shqiptar, dhe rritjen e reputacionit ndërkombëtar të institucionit tonë; përsëris bindjen se veprimtaria e SHISH, edhe në të ardhmen do të vazhdojë me modesti, por pa u lëkundur, në përmbushjen e pritshmërive që rrjedhin nga misioni i tij ligjor.

D R E J T O R I
V I S H O A J A Z I L I K A

D V